



**UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI
ZEKA” UNIVERSITY**

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e
Kosovës www.uni-gjilan.net tel:
0280390112

**RAPORT PËRMBLEDHËS PËR VLERËSIM TË STAFIT AKADEMIK SI DHE
LËNDËVE NGA STUDENTËT E UNIVERSITETIT ‘KADRI ZEKA’, PËR
SEMESTRIN VEROR TË VITIT 2020/2021**

Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi

Fitore Malaj-Abdyli

Përmbajtja

Hyrje	3
1. Metodologjia e hulumtimit	3
1.1. Qëllimi i hulumtimit.....	3
1.2. Metodat e hulumtimit	4
2. Rezultatet e Hulumtimit.....	4
2.1. Informata për rrjedhën e hulumtimit.....	4
2.2. Analiza e pyetësorëve	5
2.2.1. Qëndrimet e studentëve të Njësive Akademike në raport me pohimet e shprehura në pyetësor.....	10
2.2.2. Qëndrimet e studentëve të UKZ-Së në raport me pohimet e shprehura në pyetësor...	14
3. Përfundimet dhe rekomandimet	15

Hyrje

Ngritja e cilësisë në Universitet varet nga performanca e mësimeve gjatë ligjëratave me studentë. Rezultatet e studentëve ndërlidhen me planifikimin e punës nga ana e mësimeve, organizimin e orëve mësimore, përdorimin e materialeve të duhura për lëndë, kreativitetin e tij si dhe zbatimin e metodologjive bashkëkohore në mësimdhënie.

Duke u bazuar në Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimin në UKZ (Ref.nr.01/2280 dt.21/12/2020) si dhe Manualin për Planifikim dhe Vlerësim të Stafit Akademik (Ref.nr.01/2281 dt. 21.12.2020) është realizuar Vlerësimi i Stafit Akademik nga studentët për Semestrin Veror 2020/2021 në Universitetin “Kadri Zeka”.

Në kuadër të kësaj kemi plasuar pyetësonin në platformën SMU, të bazuar në çështjet e lartpërmendura, me anë të cilit kemi bërë matjen e realizimit të detyrave dhe përgjegjësisë që ka mësimeve karshi studentit.

1. Metodologjia e hulumtimit

1.1. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë me identifikimin e problematikave të mundshme gjatë realizimit të plan programeve mësimore të mësimeve në UKZ, trajtimin e lëndëve përkatëse si dhe qasjen në përgjithësi të obligimeve që mësimeve ka ndaj lëndës dhe studentit.

Nga ky hulumtim kemi arritur të nxjerrim vlera të cilat përcaktojnë shkallën e veprimit të mësimeve brenda angazhimit të tyre profesional nëpër lëndë të caktuara të Programeve Studimore brenda Universitetit.

Rekomandimet e dala nga ky vlerësim do t’u dorëzohen anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Cilësisë dhe Vlerësimin i cili do të rekomandojë menaxhmentit të lartë të UKZ-së për të reflektuar mbi gjetjet e hulumtimit për periudhën e Semestrit Veror 2020/2021, për përmirësimet eventuale.

1.2. Metodatat e hulumtimit

Hulumtimi u realizua kryesisht përmes metodës kuantitative dhe instrumenteve që janë në funksion të mbledhjes dhe përpunimit të dhënave.

- Shpërndarja e pyetësorëve

Meqenëse objekt hulumtimi ishin shtatë Programet Studimore (të nivelit baçelor) atëherë plasimi i pyetësorëve në SMU u bë në të gjitha Njësitë Akadematike të Universitetit, gjatë 27.05.2021 deri 6.06.2021. Plotësimi i pyetësorëve nga ana e studentëve u bë gjatë periudhës së paraqitjes së provimeve për semestrin veror 2020/2021.

2. Rezultatet e Hulumtimit

2.1. Informata për rrjedhën e hulumtimit

Duke u bazuar në instrumentet për vlerësim që përmban Manuali për Planifikim dhe Vlerësim të Performancës së Stafit Akademik (Ref.nr.01/2281 dt. 21.12.2020), studentët kanë vlerësuar sipas Shkallës së Likertit, ku studenti për secilin konstatim është dashur të rrumbullakoj 1,2,3,4 ose 5 (5=*pajtohem plotësisht*; 4=*pajtohem*; 3=*nuk e di*; 2=*nuk pajtohem*; 1=*aspak nuk pajtohem*).

Duke u mbështetur në Kalendarin Vjetor për Sigurim të Cilësisë, ku është paraparë që pas çdo Semestri të bëhet vlerësimi nga ana e studentëve. ZZHAC në bashkëpunim me KMCV-në si dhe Koordinatorët e Cilësisë janë përcaktuar forma dhe përmbajtja e pyetësorëve për semestrin veror të Vitit Akademik 2020/2021. Ku është vendosur që të vlerësohen edhe mësimdhënësit edhe lëndët e tyre.

Të gjithë studentët që iu kanë nënshtruar provimeve në afatin e qershorit kanë plotësuar pyetësorët

Në regjistrimin e pyetësorëve në formë elektronike ndihmuan edhe zyrtarët e zyrës së TI.

Duke u bazuar në Manualin për Planifikim dhe Vlerësimi të Stafit Akademik të gjithë mësimdhënësve të UKZ-së, rezultati i vlerësimit iu është dorëzuar në mënyrë individuale, në formë elektronike.

Për hartimin e Raportit me rezultatet e vlerësimit si dhe publikimin e rezultateve ka punuar kryesisht Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi.

2.2. Analiza e pyetësorëve

2.2.1 Qëndrimet e studentëve të Njësive Akademike në raport me pohimet e shprehura në pyetësor

Tabela 5. Fakulteti i Edukimit

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.63
2	Mësimdhënësi është i qartë në ligjërata	4.51
3	Mësimdhënësi është transparent	4.49
4	Mësimdhënësi është i drejtë në vlerësim	4.41
5	Mësimdhënësi është i saktë në orë	4.47
6	Mësimdhënësi është kreativ në zhvillimin e mësimin dhe aktivitetet tjera	4.41
7	Mësimdhënësi krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.36
8	Mësimdhënësi inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.48
9	Studenti lirshëm mund t'i bëjë pyetje mësimdhënësit	4.64
10	Mësimdhënësi kërkon interaktivitet gjatë ligjëratave	4.48
11	Sjellja e mësimdhënësit është në përputhje me Rregulloren	4.60
12	Mësimdhënësi është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.56
	Mesatarja e përgjithshme	4.51

Qëndrimet e përgjithshme të studentëve të Fakultetit të Edukimit janë pasqyruar në tabelën 5. Në konstatimin 1, 9 dhe 11, 12, studentët vlerësojnë lartë përgatitjen e mësimdhënësve për lëndën (4,63), ata mundën që lirshëm t'u bëjnë pyetje mësimdhënësve të tyre (4, 64) si dhe studentët vlerësojnë lart sjelljen e mësimdhënësve të tyre e cila është në përputhje me rregulloren, (4,60).

Gjithashtu një vlerësim të përafërt shohim edhe në pohimin 12 se mësimdhënësi është gjithmonë në dispozicion për konsultime me mësimdhënësin (4,56)

Një vlerësim pak më të ulët shohim tek pohimet 2, 3, 4, 5, 6, 8 10 ku studentët vlerësojnë mësimdhënësit e tyre përafërsisht njëjtë, me ndonjë dallim vogël aty këtu. Siç shihet në tabelë studentët shprehen të kënaqur rreth qartësisë së mësimdhënësit në ligjërata (4,51), transparencës së mësimdhënësve (4,49) inkurajimit për bashkëpunim dhe pjesëmarrje e studentëve (4,48) interaktivitetit gjatë ligjëratave (4,48), saktësisë së mësimdhënësve në orë mësimore (4,47), po ashtu edhe kreativitetit në zhvillimin e mësimin dhe aktivitetet tjera (4,41) . Një vlerësim më të ulët shohim tek pohimi 7 lidhur me aktivitetet që e bëjnë lëndën më të kuptueshme (4,36)

Tabela 6. Fakulteti Ekonomik

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.59
2	Mësimdhënësi është i qartë në ligjërata	4.37
3	Mësimdhënësi është transparent	4.41
4	Mësimdhënësi është i drejtë në vlerësim	4.42
5	Mësimdhënësi është i saktë në orë	4.54
6	Mësimdhënësi është kreativ në zhvillimin e mësimi dhe aktivitetëve tjera	4.41
7	Mësimdhënësi krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.32
8	Mësimdhënësi inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.35
9	Studenti lirshëm mund t'i bëjë pyetje mësimdhënësit	4.56
10	Mësimdhënësi kërkon interaktivitet gjatë ligjëratave	4.30
11	Sjellja e mësimdhënësit është në përputhje me Rregulloren	4.54
12	Mësimdhënësi është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.46
	Mesatarja e përgjithshme	4,44

Qëndrimet e përgjithshme të studentëve të Fakultetit Ekonomik për Staf Akademik janë paraqitur në tabelën 6.

Në pohimet 1,5,9,11, të kësaj tablele, të dhënat na tregojnë se studentët kanë vlerësuar pothuajse njëjtë mësimdhënësit e tyre si në përgatitjen e tyre për lëndën, saktësinë e tyre në orë mësimore, komunikimi e lirshëm që kanë studentët në ligjërata, si dhe sjelljen e mësimdhënësve e cila është në përputhje me rregulloren (mesatarja nga 4.54 deri 4.59).

Një ulje e lehtë në mesatare shihet në konstatimet 3,4,6 dhe 12 ku studentët shprehin qëndrimet e tyre karshi transparencës së mësimdhënësve, vlerësimit të drejtë, shprehjen e kreativitetit në zhvillimin e mësimi dhe aktivitetëve tjera si dhe mbajtjen e konsultimeve të rregullta me studentë (Të shprehura me mesatare nga 4,42 deri 4,46) .

Një diferencë pak më të theksuar shohim në pohimet 2,7,8, 10, ku studentët shprehin qëndrimet e tyre me një mesatare më të ulët. P.sh. me 4,30, vlerësojnë interaktivitetin në ligjërata, zhvillimin e aktivitetëve për ta bërë lëndën sa më të kuptueshme e vlerësojnë me mesatare prej 4,32, inkurajimin e studentëve për bashkëpunim gjatë ligjëratave e vlerësojnë me 4,35 kurse qartësinë e mësimdhënësit në ligjërata e vlerësojnë me 4,37,

Tabela 7. Fakulteti Juridik

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.51
2	Mësimdhënësi është i qartë në ligjërata	4.43
3	Mësimdhënësi është transparent	4.38
4	Mësimdhënësi është i drejtë në vlerësim	4.31
5	Mësimdhënësi është i saktë në orë	4.34
6	Mësimdhënësi është kreativ në zhvillimin e mësimit dhe aktiviteteve tjera	4.31
7	Mësimdhënësi krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.29
8	Mësimdhënësi inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.34
9	Studenti lirshëm mund t'i bëjë pyetje mësimdhënësit	4.48
10	Mësimdhënësi kërkon interaktivitet gjatë ligjëratave	4.33
11	Sjellja e mësimdhënësit është në përputhje me rregulloren	4.46
12	Mësimdhënësi është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.45
	Mesatarja e përgjithshme	4,39

Në tabelën 7, përkatësisht në pohimin 1, shihet se studentët e Fakultetit Juridik në mesatare më të lartë vlerësojnë përgatitjen profesionale të mësimdhënësve të tyre (4,51)

Në pohimet 2, 9,11 dhe 12 qëndrimi i studentëve është përafërsisht i njëjtë si në qartësinë e mësimdhënësve në ligjërata po ashtu edhe sjelljen e tyre dhe në gatishmërinë e profesorëve që të jenë përherë në dispozicion për konsultime me studentë.

Një vlerësim më të zbehtë studentët japin në konstatimet 3, 4, 6,8 dhe 10. Ku shihet se studentët janë më pak të kënaqur në transparencën e mësimdhënësve , vlerësimin , kreativitetin gjatë zhvillimit të aktiviteteve si dhe bashkëpunimin dhe interaktivitetin gjatë ligjëratave (Mesatarja e vlerësimit nga 4,31 deri 4,38)

Qëndrimet e studentëve karshi pohimit 7 kanë një shkallë më të ulët vlerësimi, me mesatare prej 4.29 studentet kanë vlerësuar angazhimin e mësimdhënësve në krijimin e aktiviteteve për ta bërë lëndën sa më të kuptueshme.

Tabela 8. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.35
2	Mësimdhënësi është i qartë në ligjërata	4.25
3	Mësimdhënësi është transparent	4.32
4	Mësimdhënësi është i drejtë në vlerësim	4.32
5	Mësimdhënësi është i saktë në orë	4.26
6	Mësimdhënësi është kreativ në zhvillimin e mësimiit dhe aktiviteteteve tjera	4.19
7	Mësimdhënësi krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.14
8	Mësimdhënësi inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.23
9	Studenti lirshëm mund t'i bëjë pyetje mësimdhënësit	4.42
10	Mësimdhënësi kërkon interaktivitet gjatë ligjëratave	4.26
11	Sjellja e mësimdhënësit është në përputhje me rregulloren	4.44
12	Mësimdhënësi është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.34
	Mesatarja e përgjithshme	4,30

Tabela 8 pasqyron qëndrimet e studentëve të Shkencave Kompjuterike ndaj qasjes pedagogjike të mësimdhënësve.

Nga studentët janë kërkuar përgjigje në pohimet e parashtruara sipas shkallës së Likertit (nga 1- 5). Në përgjigjet e dhëna shihet se nuk ka dallime esenciale në qëndrimet e studentëve por krahasuar me fakultetet tjera, në këtë njësi akademike studentët kanë shprehur një shkallë vlerësimi më të ulët.

Siç shohim në tabelë vlerësim më të lartë kanë pohimet 9 dhe 11, ku bëhet fjalë për komunikimin e studentëve me mësimdhënësit si dhe sjelljen e tyre konform rregullores (4,44, 4,42). Konstatimet tjera kanë qëndrim përafërsisht të njëjtë me ndonjë dallim të papërfillshëm.

Në FSHK, studentët janë shprehur më pak të kënaqur në pohimet 6 dhe 7 lidhur me kreativitetin e mësimdhënësve si dhe krijimin e aktiviteteteve në klasa për ta bërë lëndën më të kuptueshme. (4,19 dhe 4,14).

Tabela 9. Fakulteti i Shkencave Aplikative Programi- Matematikë Arsimore

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.46
2	Mësimdhënësi është i qartë në ligjëratat	4.34
3	Mësimdhënësi është transparent	4.39
4	Mësimdhënësi është i drejtë në vlerësim	4.47
5	Mësimdhënësi është i saktë në orë	4.38
6	Mësimdhënësi është kreativ në zhvillimin e mësimi dhe aktiviteteve tjera	4.30
7	Mësimdhënësi krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.26
8	Mësimdhënësi inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.45
9	Studenti lirshëm mund t'i bëjë pyetje mësimdhënësit	4.64
10	Mësimdhënësi kërkon interaktivitet gjatë ligjëratave	4.55
11	Sjellja e mësimdhënësit është në përputhje me rregulloren	4.66
12	Mësimdhënësi është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.55
	Mesatarja e përgjithshme	4,46

Në tabelën 9, janë shprehur qëndrimet e studentëve të Fakultetit të Shkencave Aplikative.

Të dhënat tregojnë se studentët në masë të madhe janë të kënaqur me qasjen e mësimdhënësve të tyre dhe këtë e shprehin në veçanti në sjelljen e mësimdhënësve e cila është në përputhje me rregulloren si dhe lirinë e tyre të shprehjes gjatë ligjëratave (Mesatarja 4,66, 4,64, Pohimi 11, 9).

Vlerësimi i studentëve rreth përgatitjes profesionale të mësimdhënësve, vlerësimit të drejtë , inkurajimit të bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së studentëve në mësim, konsultimeve të rregullta si dhe interaktivitetit gjatë ligjëratave, shohim se është i përafërt (Pohimi 1,4,8,10, 12, Mesatarja nga 4,46-4,55)

Një vlerësim më të ulët shohim tek pohimi 7, ku studentët kanë vlerësuar më pak mësimdhënësit në krijimin e aktiviteteve që e bëjnë lëndën më të kuptueshme (4,26)

1.1.1. Qëndrimet e studentëve të UKZ-Së në raport me pohimet e shprehura në pyetësor

Tabela 10. Rezultatet e përgjithshme të vlerësimit të Stafit Akademik të UKZ-së nga ana estudentëve

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	4.56
2	Mësimdhënësi është i qartë në ligjërata	4.44
3	Mësimdhënësi është transparent	4.43
4	Mësimdhënësi është i drejtë në vlerësim	4.38
5	Mësimdhënësi është i saktë në orë	4.42
6	Mësimdhënësi është kreativ në zhvillimin e mësimimit dhe aktiviteteve tjera	4.35
7	Mësimdhënësi krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	4.31
8	Mësimdhënësi inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	4.40
9	Studenti lirshëm mund t'i bëjë pyetje mësimdhënësit	4.57
10	Mësimdhënësi kërkon interaktivitet gjatë ligjëratave	4.40
11	Sjellja e mësimdhënësit është në përputhje me rregulloren	4.54
12	Mësimdhënësi është gjithmonë në dispozicion për konsultime	4.50
Mesatarja e përgjithshme		4,45

Tabela 10 paraqet të dhënat e përgjithshme të gjitha NJ.A., që kooperojnë brenda Universitetit.

Siç shihet, vlerat e shprehura me mesatare tregojnë për një qëndrim pozitiv të përgjithshëm të studentëve ndaj mësimdhënësve të tyre .

Studentët e UKZ-së në masë të madhe kanë konsideruar se mësimdhënësit e tyre janë të përgatitur për lëndën (pohimi 1, mesatarja 4.56) gjithashtu studentët kanë vlerësuar kënaqshëm edhe sjelljet e mësimdhënësve dhe konsultimet e rregullta me studentë (Pohimi 11,12 mesatarja 4,54, 4,50)

Në pohimet tjera (Pohimet 2, 3, 5, 8, 10) të gjithë studentët, me dallime shumë të vogla vlerësojnë se organizimi i mësimimit si dhe qasja e mësimdhënësve të tyre në përgjithësi është

në nivel të kënaqshëm. Rezultatet tregojnë se mësime dhënësit në masë të madhe janë transparent në punën e tyre, janë të qartë në ligjëratat, janë të saktë në orë, inkurajojnë studentët për bashkëpunim dhe pjesëmarrje në ligjëratat si dhe shprehen lirshëm gjatë ligjëratave (Mesatarja nga 4,40-4,44)

Sipas të dhënave të tabelës 10 e cila përmbledh të gjitha qëndrimet e studentëve të anketuar të të gjitha njësive akademike, shohim një ulje në vlerësim tek pohimet 4, 6 dhe 7. Studentët shprehen më pak të kënaqur me mënyrën e vlerësimit nga ana e mësime dhënëseve (4,38), në kreativitetin e zhvillimit të mësimit (4,35) si dhe në krijimin e aktiviteteve për ta bërë lëndën sa më të kuptueshme (4,31).

Tabela 11. Rezultatet e përgjithshme të vlerësimit të lëndëve në programet studimore të nivelit baçelor të UKZ-së nga ana e studentëve

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Përmbajtja e plan programit është në përputhje me literaturën bashkëkohore	4.53
2	Qëllimi dhe objektivi i lëndës është definuar qartë në syllabusin e lëndës	4.53
3	Ligjëratat vijohen në përputhje me Plan programin	4.49
4	Materialet e lëndës janë të disponueshme	4.42
5	Lënda është organizuar në mënyrë të atillë që më ka ndihmuar të kuptoj konceptet e lëndës	4.40
6	Materialet e lëndës (literatura, ligjëratat, sllajdet, etj.) kanë ndikuar në zhvillimin e njohurive dhe aftësive në fushën përkatëse	4.41
7	Aktivitetet vlerësuese (teste, prezantime, punime, etj.) më kanë ndihmuar të kuptoj më mirë materialet/konceptet e lëndës	4.40
8	Testet dhe provimi përfshijnë materialet që janë shtjelluar në klasë	4.46
9	Ambienti në orën mësimore inkurajon shprehje të mendimeve/ideve	4.40
10	Struktura e vlerësimit është e drejtë dhe e përshtatshme	4.39
	Mesatarja e përgjithshme	4,45

Në tabelën 11 kemi paraqitur rezultatet e përgjithshme të vlerësimit të lëndëve mësimore nga ana e studentëve.

Siç shihet në tabelë, studentët në një shkallë vlerësimi të lartë dhe të njëjtë kanë vlerësuar lëndët e tyre në Pohimin 1 dhe 2, si në përputhjen e plan programeve mësimore me literaturën bashkëkohore (Mesatarja 4,53) po ashtu edhe në përmbajtjen e syllabuseve , i cili qartëson qëllimin dhe objektivin e lëndës (Mesatarja 4,53)

Një ulje të vogël shohim tek pohimi 3 dhe 8 lidhur me vijueshmërinë e e ligjëratave në përputhje me plan programin (4,49) dhe në përfshirjen e materialeve të shtjelluara gjatë ligjëratave në teste dhe provime (4,46).

Një qëndrim të përafërt shohim tek pohimet 4,5,6,7,9, ku studentët shprehen më pak të kënaqur me posedimin e materialeve të lëndës, organizimin e lëndës për të njohur konceptet e reja mësimore, ndikimi i materialeve të lëndës (literatura, ligjëratat, sllajdet, etj.) në zhvillimin e njohurive dhe aftësive në fushën përkatëse (4,40- 4,42).

Me shkallë më të ulët të vlerësimit (Pohimi 10) studentët kanë vlerësuar se sa është e drejtë dhe përshtatshme struktura e vlerësimit (4.39)

3. Përfundimet dhe rekomandimet

Duke u bazuar në të dhënat e këtij hulumtimi si dhe analizën e detajuar të rezultateve mund të konstatojmë se studentët e UKZ-së, janë të kënaqur me organizimin e mësimit si në ligjërata po ashtu edhe në realizimin e plan programeve nëpër lëndë të caktuara tek të gjitha programet studimore të tyre. Këtë e vërteton mesatarja e përgjithshme e cila është 4.45

Siç shihet, mesataret e përgjithshme të Nj. A. janë mbi 4. Me mesatare më të lartë prin Edukimi me 4.51 pastaj radhiten Fakulteti i Shkencave Aplikative me 4.46, Fakulteti Ekonomik me 4.44, Fakulteti Juridik 4.39 si dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike me 4.30.

Qëndrimet e studentëve të shprehura ndaj mësimdhënies, në të gjitha NJA, pothuajse kryesisht janë të përafërta me ndonjë dallim të vogël në përqindje. Përveç në konstatimin 4,6 dhe 7 ku shkalla e vlerësimit është më e ulët.

Sipas rezultateve, studentët janë më pak të kënaqur në mënyrë e vlerësimit nga ana e mësimdhënësve, (Mesatarja 4.38). Gjithashtu shihet se mësimdhënësit e universitetit janë më pak kreativ në zhvillimin e aktiviteteve gjatë ligjëratave me studentët e tyre (Mesatarja 4,35) .

Një mesatare më të ulët, e gjejmë edhe tek pohimi 7 i cili tregon se jo të gjithë mësimdhënësit praktikojnë aktivitete në klasat e tyre për ta bërë lëndën sa më të kuptueshme (Mesatarja 4,31)

Vlen të theksohet se me një shkallë vlerësimi më të lartë me mbi 4.5 janë vlerësuar mësimdhënësit në përgatitjen e tyre për lëndën, sjelljet e tyre me studentë si dhe komunikimin e lirshëm të studentëve me mësimdhënësit.

Gjithashtu në vlerësimin për lëndët (tabela 11), studentët shprehen relativisht të kënaqur si në përmbajtjen e plan programit mësimor po ashtu edhe në hartimin e syllabusit. (Pohimi 1 dhe 2, Mesatarja 4,53) Kurse me një vlerësim më të ulët studentët shprehen lidhur me strukturën e vlerësimit, (Pohimi 10, Mesatarja 4,39)

Nga rezultatet e dala nga ky hulumtim mund të konstatojmë se roli dhe përgjegjësia e mësimdhënësit për qasje sa më bashkëkohore në realizimin e plan programit si dhe komunikimi i vazhdueshëm me studentë janë faktor kyç në ngritjen e cilësisë në UKZ. Prandaj rekomandimet e tona janë:

- Të hartohen syllabuset duke u bazuar në rezultatet e të nxënësve si dhe të monitorohet në vazhdimësi arritja e këtyre rezultateve.
- Të inkurajohen mësimdhënësit për zhvillim të vazhdueshëm profesional
- Të organizohen trajnime brenda Universitetit me qëllim të përfundimit të metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies duke u bazuar në zhvillimin e mendimit kritik tek studentët
- Mësimdhënësit të respektojnë kriteret e vlerësimit duke vlerësuar sistematikisht studentët gjatë semestrit
- Të mbikëqyret përputhshmëria e literaturës në plan program me literaturën që e përdorin mësimdhënësit me studentë.
- Të krijohen dosje personale për performancë të secilit staf akademik nëpër të gjitha NJA

- Dekanët të vazhdojnë të bëjnë koordinimin e plotë të plan programeve mësimore me kurrikulat e reja.
- Të gjinden forma të motivimit të mësimdhënësve, të cilët kanë treguar performancë të mirë gjatë vlerësimit.

